



## Shpallje e vendit të lirë të punës

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar/e për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit
<b>Grada e pozitës:</b>	6
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	me afat të pacaktuar
<b>Departamenti/ Divizioni:</b>	Divizioni i Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit
<b>Raporton tek:</b>	Udhëheqësit të Divizionit të PPP/FT

### Përmbledhja e pozitës:

Zyrtari për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, do të jetë përgjegjës për të ndihmuar Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës në ruajtjen e stabilitetit financiar përmes zbatimit të kompetencave mbikëqyrëse në institucionet financiare për të siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe aktet tjera nënligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pjesëmarrja dhe realizimi i ekzaminimeve/inspektimeve nga jashtë dhe në vend të bankave dhe institucioneve të tjera financiare, në lidhje me pajtueshmërinë me PPP/LFT;
- Përpilimi i raporteve dhe rekomandimeve pas ekzaminimeve të institucionet financiare sa i përket pajtueshmërisë me PPP/LFT;
- Ndhmon në draftimin e dokumenteve të ndryshme ligjore e rregullative për të siguruar pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në fushën e PPP/LFT;
- Përgatit raporte periodike të punës sipas nevojës dhe kërkesës së udhëheqësit të divizionit;
- Përgatit dhe drafton përgjigje në kërkesa për divizionin nga palët e jashtme, për çështje të cilat janë në përgjegjësi të divizionit;
- Me kërkesë të udhëheqësit të divizionit, merr pjesë dhe përfaqëson BQK-në dhe divizionin në takime, konferenca, trajnime etj., brenda dhe jashtë BQK-së;
- Merr pjesë në aktivitetet e divizionit dhe asiston punën e anëtarëve të njësive të tjera siç kërkohet nga udhëheqësi;
- Shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për aprovim të zyrtarëve të pajtueshmërisë për PPP/LFT (menaxherëve të lartë) të institucioneve financiare;

- Realizimin e kërkesave që ndërlidhen me plotësimin e vazhdueshëm të pyetësorëve “Know your Customer” – KYC të bankave korrespondente për fushën e pajtueshmërisë me PPP/LFT;
- Mbështet në procesin e realizimit të vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel të sektorit financiar, krijimin dhe mirëmbajtjen e profileve të rrezikut të institucioneve financiare;
- Bashkëpunimi dhe ndërlidhja me palët dhe homologët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, në lidhje me çështjet e PPP/LFT në nivel kombëtar;
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës të udhëheqësit të Divizionit ose zyrtarëve të tjerë të deleguar nga ai.

### **Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:**

- Të posedoj diplomë universitare nga fusha e ekonomisë, financave, biznesit, juridikut ose të ngjashme, ndërsa studimet pasuniversitare paraqesin përparësi;
- Minimum dy (2) vite përvoja pune në sistemin financiar ose me përgjegjësi të ngjashme profesionale;
- Të posedojë njohuri të çështjeve rregullative dhe praktikave më të mira si vendore ashtu edhe ndërkombëtare në fushën e PPP/LFT, posedimi i çertifikimeve relevante në fushën e PPP/LFT paraqet përparësi;
- Te ketë aftësi të mira komunikimi me shkrim në përpilimin e raporteve dhe politikave si dhe prezantimeve verbale;
- Të ruaj nivel të lartë të konfidencialitetit dhe integritetit;
- Të jetë ambicioz, kreativ, të posedojë aftësi profesionale;
- Të posedoj aftësi të zgjedhjes së problemeve dhe organizimit të çështjeve me prioritet;
- Njohje e mirë e aplikacioneve të pakos së MS Office;

### **Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është 22.10.2024.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>)përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)